



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

A. Të dhëna të përgjithshme

Takimi publik për konsultimin e prezantimit :Plani vendor i veprimit për mbrojtjen sociale 2025-2028.

Data e takimit: 27.08.2025

Vendi i takimit: Salla e mbledhjeve Bashkia Elbasan

Ora e hapjes së takimit: 10:30

Kryesuesi i takimit: Nadire Kreka,Lindita Senia

Këshilltarë pjesëmarrës në takim, nr -

Anëtarë të Komisionit të Përhershëm të Shërbimeve dhe Strehimit Social

Nr -

Punonjës të administratës pjesëmarrës në takim, nr 15

Anëtarë të strukturave komunitare pjesëmarrës në takim, nr 6

Emrat Kristina Kreka;Alban Shengjergji;Redi Puqe;Ervis Cota,Nadire Kreka,Saimir Bakalli

Pjesëmarrës në takim nga komuniteti: nr 2

Nga të cilët vajza/gra: nr 12

- B. Zhvillimi i takimit. Znj Nadire Kreka-Bën Prezantimin. Plani vendor për mbrojtjen sociale 2025-2028 përshkruan prioritetet e Bashkisë Elbasan në fushën e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale deri në vitin 2028.Ky plan ka ndryshime në :1-Update-imin e të dhënave. 2-Ka shtojcë plani i integritetit i shtresave vulnerable. 3-Plani është bërë në gjuhë të ndjeshme gjinore.
- C. Planet nuk mbivendosen me njëri tjetrin,aktivitetet janë shpërndarë në mënyrë të saktë në çdo plan social,integriteti,barazie gjinore.Janë 6 objektiva:Aksesi i barabartë në regjistrimin civil dhe në drejtësi.Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor.Kultura shëndetsore.Punësimi dhe formimi profesional.Strehimi dhe integrimi urban..Mbrojtja sociale.

Folësi -Kristina Kreka

Komente/Rekomandime Bën disa sygjerrime në matricën e objektivave.Tek monitorimi duhet të jetë edhe Drejtorja e Financës përveç Drejtorisë së Mbrojtjes dhe përfshirjes Sociale.Tek aktorët shtu edhe Administratori Social tek informacioni mbi regjistrimin civil.

Folësi -.Nadire Kreka.

Informimi i komunitetot rom mbi fenomenin e trafikimit.Identifikimi dhe referimi i rasteve tek strukturat përgjegjëse.Të gjithë duhet të informohen,kjo çështje kërkon ndërhyrje edhe më të larta.

Folësi -Kristina Kreka

Komente/Rekomandime Tek aktorët duhet shtuar edhe KVSP

Folësi -Ervis Çota

Komente/RekomandimeNë lidhje me çështjen e arsimit,ndikon edhe varfëria tek moshkontrollimi i këtyre shtresave.Duhet punë sistematike,duhen ndjekur rastet,duhet kordinuar me shkollat që të raportojnë mungesat për nxënësit që nuk paraqiten në shkollë apo lën orët e mësimi.Qendra komunitare luan një rol të rëndësishëm këtu.Qendrat duhet të jenë aktive.Duhet marrë nga shkolla lista e nxënësve dhe të merret qendra me këta fëmijë,mdje ti ndihmojë në detyrat e shtëpisë.

Folësi-Nadire Kreka.

Tek objektivi i kujdesit shëndetsor duhet kujdesi i nënave të reja,përkujdesi që ato kanë për fëmijën,për përgjegjësitë që kanë si prind apo si bashkëshorte etj.Të përfshihen programe që nënat e reja të mësojnë te qendrat komunitare.

Folësi -Ervis Çota

Komente/Rekomandime Duhet bër takime të hapura një herë në javë në lagje me qendrat e kujdesit shëndetsor ,me komunitetin ku të marrin informacionin e duhur për vaksinat,për kujdesin e fëmijëve,për shëndetin e fëmijës etj.

Folësi -.Nadire Kreka.

Qendrat e kujdesit kanë bër shumë aktivitete për informimin e romëve,për sëmundje të ndryshme,për kujdesjen etj.Është edhe detyra e qendrave të kujdesit shëndetsor të bëjnë edhe ato informimin.

Folësi - Ervis Çota

Komente/Rekomandime Tek punësimi dhe formimi profesional kjo shtresë e shikon veten tek shërbimet komunitare.Elbasani nuk i ofron shumë kto lloj shërbimesh sepse ka nga ata që nuk dijnë të shkruajnë ose të lexojnë.Vem theksin tek qëndrueshmëria.Shumë rom kanë punuar dhe kanë dashur të punojnë akoma dhe më shumë në atë vend pune por për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të punojnë më aty.Përqindja më e madhe e regjistruar tek zyra e punës janë Egjiptianë ku ata trajtohen edhe me ndihmë ekonomike.

Folësi – Lindita Senia Trajnime dhe këshillime për Romët dhe Egjiptianët.Duhet të trajnohen me oraret e punës,me kushtet,me edukatën për të qen korrekt në punë etj.Ai që merr ndihmë ekonomike duhet ta kthejë në komunitet me shërbim.

Folësi -Ervis Çota

Komente/RekomandimeTek strehimi dhe integrimi urban tek programi i parë ka nevojë të ndërhyet,rikonstrukcioni i banesave.Rikonstrukcion/përmirsim kushtesh.Mirë është ti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

sjellim rastet që kemi,ti mbledhim mbi 10 raste e të bëjnë një aplikim.Janë banesa të banueshme por kanë nevojë për rregullime të tjera.

Folësi -Redi Puqe

Komente/RekomandimeOrganizatat e shoqërisë civile mund të jenë të përfshira pak më shumë.Tek formimi profesional apo disa pika të tjera këto organizata duhet të përfshihen më shume.

Folësi – Nadire Kreka

I kemi lënë të hapura Shoqatat,Donatorët,nuk i kemi cituar me emra por janë të përfshira.

Mbyllja e takimit. Ora 11:30

Përgjegjëse e Konsultimeve Publike

Alba Papa

